
NEKROLOGJI

FILIP LIÇO

1915-2011



Më datë 29 maj të vitit 2011 u nda nga jeta studiuesi i njohur Filip Liço.

Filip Liço lindi në nëntor të vitit 1915 në fshatin Derviçan të Dropullit të rrethit të Gjirokastrës. Katër klasët e fillores i kreu në vendlindje, ndërsa 3 klasët më lart për përfundimin e 7-vjeçares në Vostinë të krahinës së Pogonit. Shkollën e mesme me 5 klasë e vijoi në normalen e Vellas së Janinës.

Në shtator të vitit 1936 me përfundimin e Normales u emërua mësues në fshatin e tij Derviçan. Për pesë vjet ishte mësues i greqishtes në minoritetin grek. Në prill të 1941 u emërua mësues në fshatin (Moshoci) të Pogonit.

Gjatë luftës së Dytë Botërore u aktivizua në lëvizjen antifashiste madje u pëfshi në Ushtrinë Nacionalçlirimtare greke (ELAS), përkatësisht luftoi në radhët e Brigadës X të saj.

Në Shqipëri u rikthye në maj të 1945-ës dhe u emërua kryeredaktor i gazetës “Llaiko Vima”, që dilte në gjuhën greqisht për minoritetin etnik grek.

Në periudhën 1947-1955 pati nëpunësi të ndryshme dhe njëkohësisht vijoi studimet në arsimin e lartë.

Në vitin 1955 u diplomua në Institutin e Historisë.

Në shtator të 1964-ës u emërua pedagog i greqishtes në Fakultetin Histori-Filologji kurse në nëntor të 1970-ës punonjës shkencor në Institutin e Historisë. Edhe pas daljes në pension në gusht të vitit 1977 vazhdoi të punojë në këtë Institut si bashkëpunëtor i jashtëm. Në vitet 1980-1990 përgatiti punimin “Dropulli – studim historiko-gjuhësor” i cili ka mbetur ende i pabotuar.

Në 20 vitet që pasuan (1991-2010) iu kushtua studimit të marrëdhënieve shqiptaro-greke. Fryt i veprimtarisë shkencore të F. Liços janë një seri botimesh, të realizuara që rrokin disa fusha:

Në fushën e gjuhësisë:

1. Gramatika e greqishtes së re, f. 336, Tiranë 1972
2. Libër leximi me tekste në Katharevusa (e pastër), Tiranë 1972, f. 136
3. Sintaksa e greqishtes së re, Tiranë 1973, f. 48

Në fushën e historisë:

1. Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë me bashkautor Koço Bozhori, Tiranë 1975, f. 385
2. Kronika e Dropullit (në gjuhën greqisht), Tiranë 2008, f. 150
3. Probleme të marrëdhënieve greko-shqiptare, Tiranë 2009, f. 505

Artikuj shkencorë:

1. Politika greke ndaj Shqipërisë në shek.XIX në “Studime historike, nr. 3, 1977, f. 48.
2. Anastas Kullurioti dhe çështja shqiptare, në “Studime historike”, , 1980, f. 50.
3. Fillimet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në “Studime historike”, 1982, nr. 2, f. 20.

Filip Liço ishte një studiues pasionant i historisë. Ndonëse koha që i kushtoi asaj ishte jo aq sa do të kishte dashur, ai la gjurmët e veta në mes të një plejade të tërë historianësh, që dhanë kontribut të çmuar në formësimin e historiografisë shqiptare.

Filipi u nda nga kjo jetë duke lënë te kolegët, miqtë dhe natyrisht, familjarët, kujtimin e njeriut të qetë, human, të kulturuar e punëtor.

Marenglen VERLI